



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



SINJALIZIMI I KORRUPSIONIT

Çfarë është sinjalizimi?

"Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit të njësisë përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës, në autoritetin publik apo subjektin privat.




Kush mund të jetë sinjalizues?

"Sinjalizues" është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

Cfarë konsiderohet veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni?

"Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë/institucion, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.



Sinjalizimi duhet të kryhet në kushtet e mirëbesimit!


Vetëm për sinjalizimet në mirëbesim, sinjalizuesi përfiton mbrojtje nga Ligji 60/2016.

KUJDES: Sinjalizuesi humbet të drejtën për tu mbrojtur, sipas këtij ligji, në çastin kur sinjalizimi bëhet publik!

TË DREJTAT E SINJALIZUESIT


Sinjalizuesi gëzon të drejtën e:

- a. konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, që përfshin, gjithashtu, mundësinë e sinjalizimit anonim të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni;
- b. ruajtjen e konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuesit;
- c. mbrojtjes kundër hakmarrjes.



Kur garantohen të drejtat e sinjalizuesit?

1. Gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;
2. Pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, me qëllim kryerjen normale të detyrave funksionale të sinjalizuesit në organizatën/institucionin e tij.
3. Pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me organizatën/institucionin e tij, kur, nga rrethana të bazuara dhe të arsyeshme, sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen nga ILDKPKI.



Të drejtat e sinjalizuesit kanë epërsi ndaj çdo marrëveshjeje të konfidencialitetit!

4 HAPAT QË DUHET TË NDIQNI PËR TË SINJALIZUAR



1. Sinjalizo pranë Njesisë Përgjegjëse në Instiucionin ku punon

Pranë çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar dhe çdo autoriteti privat, i cili ka më shumë se 100 të punësuar, caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet tuja, sipas parashikimeve të Ligjit.

Ky sinjalizim konsiderohet "sinjalizim i brendshëm"

2. Sinjalizo pranë ILDKPKI

(Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.)

Çdo sinjalizues ka të drejtë të sinjalizojë drejtpërdrejt në ILDKPKI në rastet e mëposhtme:

- Kur njësia përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin.
- Kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në njësinë përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.
- Kur ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit.
- Kur prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata/institucioni

Ky sinjalizim konsiderohet "sinjalizim i jashtëm"



3. Cfarë forme duhet të ketë sinjalizimi?

Sinjalizimi mund të bëhet **me shkrim ose verbalisht** pranë Njesisë Përgjegjëse ose ILDKPKI.

4. Sinjalizimi duhet të përmbajë:

- të dhënat e identitetit tuaj;
- të dhënat e kontaktit tuaj;
- përshkrimin e fakteve shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
- referimin përkatës në Kodin Penal për aq sa është e mundur.





U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Kjo fletëpolosje u prodhua në kuadër të projektit "Për një zbatim më të mirë të legjislacionit për sinjalizuesit", mbështetur nga Programi i Grantëve të Vogla, në Ambasadën e Sh.B.A.-ve në Tiranë.


SINJALIZIMI MUND BËHET EDHE ANONIM!



Sinjalizimi anonim pranohet, nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimitit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.

Sinjalizuesit gëzojnë mbrojtje nga çdo masë hakmarrëse!
Masat ndaj të cilave ofrohet mbrojtje nga ligji janë:

- a. shkarkimi nga puna;
- b. pezullimi nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- c. transferimi brenda ose jashtë organizatës;
- ç. ulja në detyrë;
- d. ulja e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
- dh. humbja e statusit dhe të privilegjeve;
- e. mosngritja në detyrë;
- ë. heqja e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- f. vlerësimet negative në marrëdhënien e punës;
- g. forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.



Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, paraqet kërkesë për mbrojtje të njësisë përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, të cilat marrin masat e duhura për riparimin e pasojave të pallgjshme nga akti i hakmarrjes.



Kërkoni dëmshpërblim në rastin e hakmarrjes!

Çdo sinjalizues ka të drejtë të kërkojë në gjykatë shpërblim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes, në kuptim të këtij ligji, sipas Kodit Civil.